



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ___/___/2022

V E N D I M

Nr. 22, datë 20/01/2022

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar¹, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 152, datë 05.08.2021, e z. M. O. B., i datëlindjes _____.____.____, lindur në Corlu, Turqi dhe banues në Sarandë, i përfaqësuar me Prokurë të Përgjithshme nga Av. Gj. I., ku pretendohet diskriminim për shkak të origjinës dhe për shkak të statusit si i huaj, nga ana e Departamentit për Kufirin dhe Migracionin pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, Drejtorisë për Kufirin dhe Migracionin Vlorë dhe Komisarariatit të Kufirit dhe Migracionit Sarandë.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi²,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas informacionit të dhënë në ankesë, shtetasi turk M. O. B. ka qenë me qëndrim të përkohshëm prej katër vitesh në Shqipëri. Ankuesi ka qenë banues në qytetin e Sarandës³. Njëkohësisht, ai sqaron se ushtronte biznesin e tij të ligjshëm si person fizik, i cili konsiston në një agjensi turistike me vendndodhje në Ksamil, Vlorë, si dhe është pronar i anijes Nordic Berry, e cila është e regjistruar në Portin e Durrësit dhe është lejuar të lundrojë me Flamurin e

¹ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën LMD;

² Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën KMD;

³ Aktualisht ankuesi është larguar në Turqi, si pasojë e akteve të lëshuara për largimin e tij nga territori i RSH dhe refuzimit të lejes së qëndrimit.

Republikës së Shqipërisë, deri në datën 19.04.2022⁴. Ankuesi sqaron se biznesi i tij është i regjistruar pranë organeve tatimore dhe se ai ka qenë tatim/taksapagues i rregullt pranë të gjithë institucioneve përgjegjëse. Z. M.B. është pajisur me leje të rregullt qëndrimi nga autoritetet shqiptare, të cilat janë përsëritur periodikisht, deri në momentin që ai ka marrë dijeni mbi lëshimin e Urdhërit nr. 919/2, datë 07.07.2021, të Drejtorit të Drejtorisë Vendore për Kufirin dhe Migracionin Vlorë, “Për largimin nga territori i Republikës së Shqipërisë”, shkresës nr. 919/3, datë 07.07.2021 “Njoftim për refuzimin e lejes së qëndrimit dhe urdhërit të largimit”, si dhe shkresës së datës 07.07.2021 “Refuzim/heqja e lejes së qëndrimit”, së Drejtorisë Vendore për Kufirin dhe Migracionin Vlorë.

Ankuesi thekson faktin se i ka ankimuar aktet e sipërcituara pranë Departamentit për Kufirin dhe Migracionin, të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, duke kërkuar shfuqizimin e tyre, por ankimi i tij nuk është pranuar nga ky institucion. Ankuesi sqaron se është një shtetas tepër i rregullt në raport me ligjet e shtetit shqiptar, si dhe nuk ka patur asnjëherë probleme të natyrës ligjore në ngarkim të tij. Në këtë kontekst, z. M.B. shprehet se aktet e sipërcituara nuk e sqarojnë shkakun e largimit të tij nga territori i Republikës së Shqipërisë, si dhe thekson faktin se ai nuk është në dijeni të ndonjë informacioni nëse Shërbimi Informativ Shtetëror, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Drejtoria për Kufirin dhe Migracionin apo Ministri i Brendshëm të kenë kërkuar fillimin e hetimit apo procedimin e tij penal për ndonjë vepër penale, që ka të bëjë me sigurinë kombëtare, rendin publik apo çështje të tjera të kësaj natyre.

Mbështetur në sa më sipër, ai pretendon se diskriminohet për shkak të origjinës dhe për shkak të statusit si i huaj, nga ana e Departamentit për Kufirin dhe Migracionin pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, Drejtorisë për Kufirin dhe Migracionin Vlorë dhe Komisarariatit të Kufirit dhe Migracionit Sarandë.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Hapat procedurialë të ndjekur nga strukturat përkatëse të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, paraqiten si më poshtë vijojnë:

- A.** Pas analizimit të ankesës nr. 152, datë 05.08.2021, u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33, pika 3 të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar. Për këtë arsye, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.

⁴ Referuar aktit Dëshmi për të Drejtën e Lundrimit me Flamurin e Republikës së Shqipërisë, lëshuar nga Kapiteneria e Portit Durrës.

B. Mbështetur në nenin 33, pika 7⁵, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi iu drejtua subjekteve dhe për dijëni ankuesit, me shkresën nr. 1167/2 prot., datë 11.08.2021, ku kërkohej informacion, si më poshtë vijon:

- Informacion i përgjithshëm mbi pretendimet e ankuesit;
 - Kopje e të gjitha kërkesave për leje qendrimi të z. M.B. dhe lejeve të qendrimit të tij në Shqipëri, të lëshuara nga organet kompetente;
 - Kopje e dosjes së ankuesit, që administrohet nga institucionet përgjegjëse;
 - Kopje e korrespondencës zyrtare të secilit institucion me ankuesin;
 - Kopje të akteve të dala nga secili institucion, që kanë të bëjnë me çështjen e refuzimit të lejes së qendrimit për z. M.B. dhe largimin e tij nga Republika e Shqipërisë;
 - Informacion i hollësishëm mbi shkakun/qet e refuzimit të lejes së qendrimit të z. M.B., si dhe depozitimi i akteve, që provojnë shkakun/qet e refuzimit dhe largimit të tij nga Republika e Shqipërisë;
 - Informacion mbi numrin e shtetasve turq, të cilëve u është refuzuar leja e qendrimit në Shqipëri dhe u është kërkuar largimi nga territori i RSH-së përgjatë viteve 2019-2021. Informacioni të jepet specifikisht për secilin vit, si dhe të jepen arsyet e kësaj vendimmarrjeje;
 - Informacion mbi numrin e shtetasve të huaj (duke përcaktuar shtetësinë përkatëse), të cilëve u është refuzuar leja e qendrimit në Shqipëri dhe u është kërkuar largimi nga territori i RSH-së përgjatë viteve 2019-2021. Informacioni të jepet specifikisht për secilin vit, si dhe të jepen shkaqet e kësaj vendimmarrjeje;
- Drejtoria Vendore e Kufirit dhe Migracionit Vlorë dërgoi pranë KMD-së, shkresën nr. 1138/2, datë 17.08.2021. Me anë të kësaj shkrese, kjo drejtori informon se nëpërmjet shkresës së saj nr. 1138/1, datë 16.08.2021, i ka përcjellë strukturës së saj eprore, Departamentit për Kufirin dhe Migracionin, informacion sqarues dhe dokumentacionin përkatës, në lidhje me procedurat e aplikimit për leje qendrimi të shtetasit të huaj M.O.B.. Ky dokumentacion i është vënë në dispozicion nga Komisariati i Policisë Kufitare Sarandë, ku ka vendbanimin ankuesi, i cili është në varësi të Drejtorisë Vendore e Kufirit dhe Migracionit Vlorë.

⁵ Neni 33, pika 7, i ligjit 10 221/2010, parashikon: “Me marrjen e ankesës, komisioneri verifikon faktet. Për këtë qëllim, komisioneri mund t’u kërkojë ankuesit dhe personit kundër të cilit është drejtuar ankesa, të paraqesin parashtrime me shkrim brenda 30 ditëve nga dita që palët marrin njoftimin. Kur e çmon të nevojshme, komisioneri merr informacione dhe nga çdo person ose burim tjetër”.

Refuzimi i kërkesës për leje qëndrimi, si dhe lëshimi i urdhër largimit nga Drejtoria Vendore e Kufirit dhe Migracionit Vlorë për shtetasin e huaj është kryer në zbatim të ligjit nr. 108/2013 “Për të huajt”, i ndryshuar, si dhe të gjithë akteve ligjore dhe nënligjore që normojnë procedurat e aplikimit, vlerësimit dhe miratimit të kërkesave për leje qëndrimi.

Bashkëlidhur shkresës së sipërcituar janë dërguar aktet e mëposhtëme:

1. Praktika e urdhër largimit nr. 2865 prot., datë 29.11.2018, lëshuar ndaj shtetasit turk nga momenti para pajisjes me leje qëndrimi për herë të parë. (Fotokopje e Urdhërit të largimit, Raport shërbimi i datës 28.11.2018, informacion i PKK Port Sarandë në lidhje me konstatimin e shkeljes, informacion i Shërbimit të Migracionit të KPK Sarandë në lidhje me rastin, formulari i përzgjedhjes, fotokopje e pasaportës dhe lejes së punës – 11 fletë);
 2. Kopje të të gjithë kërkesave dhe dokumentacionit për leje qëndrimi të z. M.B. dhe të lejeve të qëndrimit të administruara nga Komisariati i Policisë Kufitare Sarandë, të cilat i janë përcjellë Drejtorisë Vendore e Kufirit dhe Migracionit Vlorë në shkresat nr. 669/3, datë 10.08.2021 dhe nr. 669/4, datë 10/08.2021, si dhe nr. 669/5, datë 10.08.2021;
 3. Shkresë nr. 919/3 prot., datë 07.07.2021, shkresë nr. 919/1, datë 07.07.2021 për refuzimin e lejes së qëndrimit, Urdhër largimi nr. 919/2, datë 07.07.2021 si dhe kartelë daktiloskopike;
 4. Shkresë me nr. M-36/1 prot., datë 23.07.2021, të DPK.
- Në përgjigje të shkresës nr. 1167/2 prot., datë 11.08.2021, së KMD-së, Departamenti për Kufirin dhe Migracionin, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit dërgoi shkresën nr. 2742/4 prot., datë 18.08.2021, ku informon se pas marrjes së informacionit përkatës nëpërmjet shkresës nr. 1138/1 prot., datë 16.08.2021, të DVKM, analizoi problematikën e ngritur në ankesë dhe pretendimin për diskriminimi të ankuesit. Në vijim të kësaj analize, ky institucion e informon KMD-në se strukturat e migracionit në nivel qëndror dhe vendor ushtrojnë kompetencat e tyre ligjore në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, ligjin nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, ligjin nr. 108/2013 “Për të huajt”, i ndryshuar, ligjin nr. 71/2016 “Për kontrollin kufitar”, VKM nr. 513, datë 13.06.2013 “Për përcaktimin e kritereve, të procedurave dhe dokumentacionin për hyrjen, qëndrimin dhe trajtimin e të huajve me leje qëndrimi”, e ndryshuar, si dhe akteve të tjera që normojnë procedurat e vlerësimit dhe të miratimit të kërkesave për lëshim apo rinovim të lejeve të qëndrimit të shtetasve të huaj që kërkojnë të qëndrojnë në Republikën e Shqipërisë për motive të parashikuara në ligj.

Gjatë ushtrimit të funksioneve dhe kryerjes së procedurave për trajtimin e të huajve në territor, ato udhëhiqen nga parimi kushtetues i mosdiskriminimit.

Zbatimi i këtyre parimeve shprehet me faktin që këtij shtetasi nuk i është mohuar e drejta për t'u trajtuar me leje qëndrimi që prej vitit 2019 nga Komisariati i Policisë Kufitare Sarandë, institucion në varësi të Drejtorisë Vendore për Kufirin dhe Migracionin Vlorë, megjithëse qëndrimi i tij në atë periudhë ishte bërë i parregullt. Në zbatim të nenit 106/1/a të ligjit nr. 108/2013 *“Për të huajt”*, i ndryshuar, shtetasi M. O. B. ka pranuar dhe ekzekutuar urdhrin e largimit vullnetar për 4 muaj nga Republika e Shqipërisë, për t'u trajtuar në vijim me leje qëndrimi për motiv punësimi për periudhën 11.06.2019-11.06.2020, në zbatim të procedurave të lëshimit të lejes së qëndrimit të shtetasve të huaj në Republikën e Shqipërisë.

Shtetasi i huaj M.O.B., i datëlindjes 21.02.1991, identifikuar me pasaportë nr. UI4336028, është pajisur për herë të parë me leje qëndrimi 1-vjeçare për arsye punësimi (si operator turistik-menaxher) me afat vlefshmërie nga data 11.06.2019-11.06.2020, duke dorëzuar dokumentacionin përkatës. Leja e qëndrimit i është miratuar sipas procedurës ligjore.

Megjithëse jo prezent në territorin e RSH, duke marrë parasysh situatën e Covid-19, shtetasit M.O.B. i është pranuar aplikimi për rinovimin e lejes së qëndrimit me datën 27.05.2020 dhe pas vlerësimit të këtij aplikimi sipas procedurës përkatëse ligjore është trajtuar përsëri me leje qëndrimi për motiv punësimi, për periudhën 12.06.2020-12.06.2021.

Për sa më sipër, në trajtimin e shtetasit turk nuk evidentohet asnjë element diskriminimi, duke e trajtuar atë në mënyrë të barabartë si çdo shtetas tjetër, të huaj, në territorin e Republikës së Shqipërisë. Referuar refuzimit të aplikimit për rinovimin e lejes së qëndrimit të datës 06.05.2021, Departamenti për Kufirin dhe Migracionin informon se shtetasit i është njoftuar lëshimi i urdhrit të largimit nr. 919/2, datë 07.07.2021 për 5 vite nga territori i Shqipërisë, në zbatim të procedurave ligjore të normuara në Udhëzimin e Përbashkët nr. 265, datë 25.05.2015, të Ministrit të Brendshëm dhe Shërbimit Informativ të Shtetit, bazuar në nenin 106, pika 1, gërma a) të ligjit nr. 108/2013 *“Për të huajt”*, i ndryshuar, pasi i huaji nuk plotësonte më kushtet e qëndrimit në Republikën e Shqipërisë, për shkak të refuzimit të lejes së qëndrimit më datë 07.07.2021, për mosplotësim të kriterëve të qëndrimit sipas pikës 1 (c) të nenit 35 të ligjit në fjalë. Në zbatim të Kodit të Procedurave Administrative, këto akte i janë komunikuar shtetasit të huaj duke i bërë me dije të drejtën për të ushtruar ankimin administrativ në gjykatë dhe aktualisht çështja është për shqyrtim pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë.

Lidhur me informacionin e kërkuar nga KMD, Departamenti për Kufirin dhe Migracionin, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit informon se në referencë të bazës ligjore të sipërcituar, procedurat për lëshimin apo rinovimin e lejes së qëndrimit për shtetasit e huaj, ndër të tjera përfshijnë edhe vlerësimin në rrugë elektronike dhe shkresore nga autoritete

të tjera ligjzbatuese dhe ky komunikim është i klasifikuar. Bazuar në ligjin nr. 8457, datë 11.02.1999 “Për informacionin e klasifikuar sekret shtetëror”, strukturat e migracionit në Departamentin për Kufirin dhe Migracionin ndjekin me rigorozitet procedurën e mirëpërcaktuar për trajtimin e rasteve të refuzimit të lejes së qëndrimit për shkak të cënimit të sigurisë publike dhe kombëtare nga i huaji, duke i njoftuar të huajit vetëm bazën ligjore, të cilës i referohet ky refuzim.

Gjatë njoftimit të këtyre akteve, bazuar në procedurat e miratuara të punës, shtetasit të huaji i bëhen me dije vetëm shkeljet ligjore, në të cilat bazohen këto akte, ndërsa nuk lejohet t’i komunikohet informacioni origjinal i klasifikuar apo struktura e burimit të këtij informacioni.

Strukturat qendrore dhe vendore të Departamentit për Kufirin dhe Migracionin që kanë trajtuar aplikimin për rinovimin e lejes së qëndrimit të këtij shtetasi nuk kanë asnjë dijeni mbi motivin e saktë të refuzimit të lejes së qëndrimit të këtij shtetasi. Ky informacion konsiderohet i klasifikuar dhe mund t’i njoftohet nga struktura burim, vetëm strukturave superiore në Policinë e Shtetit apo Ministrinë e Brendshme (Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit dhe Ministrin të Brendshëm) me kërkesë të tyre. Në asnjë rast këto informacione nuk mund të përdoren si provë në gjykim apo referencë publike për argumentimin e një mase të karakterit zyrtar administrativ, siç është refuzimi i lejes së qëndrimit në Republikën e Shqipërisë.

Lidhur me informacionin vijues të kërkuar nga KMD, ky institucion sqaron se arsyet e refuzimit të lejes së qëndrimit janë të ndryshme, sikurse përcaktohet në nenin 35, pika 1, të ligjit nr. 108/2013 “Për të huajt”, i ndryshuar. Nga analiza e të dhënave në Regjistrin Elektronik për të Huajt (FER), për periudhën 2019 e në vijim janë refuzuar gjithsej 483 aplikime nga të cilat vetëm 17 janë për shtetasit turq.

- a) 431 aplikime janë refuzuar në fazën e vlerësimit nga struktura vendore e migracionit në DVKM, kryesisht për këto arsye: 1. Mosdorëzim të dokumentacionit ligjor brenda afatit, parashikuar nga neni 38, pika 3, të ligjit nr. 108/2013 “Për të huajt”, i ndryshuar) dhe 2) tejkalim të afatit të qëndrimit mbi 60 muaj jashtë territorit, parashikuar nga neni 37, pika 2, të ligjit nr. 108/2013 “Për të huajt”, i ndryshuar;
- b) 11 aplikime janë refuzuar në fazën e vlerësimit nga struktura qendrore e migracionit në DKM, kryesisht kur i huaji, referuar dëshmisë penale nga vendi i origjinës ka kryer vepër penale dhe është dënuar me jo më pak se 2 vite burg, parashikuar nga neni 106, pika 1 (b), të ligjit nr. 108/2013 “Për të huajt”, i ndryshuar dhe qëndrimi i tij mund të çënojë sigurinë publike sipas nenit 35, pika 1(c) të të njëjtit ligj;
- c) 41 aplikime janë refuzuar në fazën e vlerësimit nga Strukturat e Antiterrorit në Policinë e Shtetit dhe strukturat e tjera ligjzbatuese, për cënim të sigurisë publike dhe kombëtare sipas neni 35, pika 1 (c) të ligjit të sipërcituar.

Njëkohësisht, Departamenti për Kufirin dhe Migracionin, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit sqaron se kopje të praktikave për ankuesin do të përcillen pranë KMD-së nga ana e Drejtorisë Vendore të Kufirit dhe Migracionit Vlorë.

- Shkresat e sipërcituara të subjekteve kundër së cilave është drejtuar ankesa iu dërguan për dijeni me e-mail përfaqësuesit ligjor të ankuesit.
- Në vijim të procedurave hetimore, nëpërmjet shkresës nr. 1447, datë 15.10.2021, së KMD-së, palët u njoftuan për seancë dëgjimore, e cila u vendos të realizohet në datën 29.10.2021, ora 11:00, pranë Zyrës së KMD-së.

Në seancë dëgjimore nuk u paraqit asnjë nga palët në këtë proces hetimi administrativ të ankesës nr. 152, datë 05.08.2021.

- Departamenti për Kufirin dhe Migracionin, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit dërgoi shkresën nr. 1447/1, datë 29.10.2021, nëpërmjet së cilës e informon KMD-në se ky Departament nuk ka informacion plotësues për të paraqitur në seancë dëgjimore dhe për shkak të angazhimeve të rëndësishme, përfaqësuesit nga DVKM Vlorë dhe Departamenti për Kufirin dhe Migracionin nuk do të marrin pjesë në seancë dëgjimore.

I. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

Mbështetur në provat e administruara gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri vlerëson se:

1. Lidhur me trajtimin e padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë të ankuesit.

Ligji nr.79/2021 “Për të huajt”⁶ rregullon regjimin e hyrjes, të qëndrimit, të punësimit dhe të daljes së të huajve në/nga Republika e Shqipërisë, si dhe përcakton funksionet dhe kompetencat e autoriteteve shtetërore dhe të subjekteve të tjera, publike e private, shqiptare ose të huaja, që në përputhje me parimin e interesit më të mirë të fëmijës, parimin e së drejtës për jetë familjare, parimin e moskthimit, parimin e procedurave të drejta dhe transparente dhe parimin e mosdiskriminimit të kryejnë aktivitete në Republikën e Shqipërisë, të cilat kanë të bëjnë me të huajt që kërkojnë të hyjnë, që hyjnë, qëndrojnë dhe dalin nga Republika e Shqipërisë.

Sipas nenit 2, pika 1, të këtij ligji, subjekt i këtij ligji janë të huajt, të cilët hyjnë ose synojnë të hyjnë në Republikën e Shqipërisë, me qëllim qëndrimin, kalimin transit, punësimin, studimin,

⁶ Ky ligj ka shfuqizuar ligjin nr. 108/2013 “Për të huajt”, i ndryshuar, mbi bazën e së cilit janë kryer procedurat përkatëse nga institucionet përgjegjëse për z. Mustafa M.B..

si dhe në rastet kur dalin nga Republika e Shqipërisë. Në kuptim të nenit 3, pika 9, të këtij ligji “I huaj” është çdo person, me ose pa shtetësi, i cili, sipas legjislacionit shqiptar, nuk është shtetas shqiptar.

Neni 4 i ligjit të sipërcituar përcakton autoritetet përgjegjëse mbi çështje që kanë të bëjnë me te huajt. Kështu në bazë të pikës 9, të këtij nenit autoriteti shtetëror qendror përgjegjës për trajtimin e të huajve dhe kthimet në Republikën e Shqipërisë është struktura përgjegjëse për kufirin dhe migracionin. Sipas pikës 11, të tij, autoriteti shtetëror përgjegjës për vlerësimin e sigurisë kombëtare është struktura që mbulon shërbimin informativ shtetëror në nivel qendror, ndërsa në bazë të pikës 12, të nenit 4, autoriteti shtetëror përgjegjës për vlerësimin e cenimit të sigurisë publike është struktura përgjegjëse e Policisë së Shtetit. Njëkohësisht, autoritetet shtetërore përgjegjëse për mbikëqyrjen dhe kontrollin e të huajve janë strukturat përgjegjëse për kufirin dhe migracionin, strukturat e rendit e të sigurisë publike në Policinë e Shtetit, si dhe zyrat përgjegjëse për gjendjen civile.

Në kuptim të nenit 31 të këtij ligji i huaji mund të qëndrojë në Republikën e Shqipërisë për një periudhë afatshkurtër, për një periudhë të përkohshme, si dhe të përhershme. Qëndrimi për një periudhë afatshkurtër nuk mund të kalojë afatin 90 ditë për 180 ditë, në bazë të vizës së lëshuar apo hyrjes pa vizë, përjashtuar kur përcaktohet ndryshe në këtë ligj ose në marrëveshje të njohura nga Republika e Shqipërisë. Qëndrimi për një periudhë të përkohshme dhe të përhershme mund të realizohet vetëm nëpërmjet pajisjes të të huajit me leje qëndrimi.

Në nenin 32 të ligjit nr.79/2021 “Për të huajt” parashikohen llojet e lejeve të qëndrimeve. Në këtë nen parashikohet se:

“1. Autoriteti përgjegjës për kufirin dhe migracionin pajis me njërën nga llojet e lejeve të qëndrimit të mëposhtme të huajt, të cilët kërkojnë të qëndrojnë në Republikën e Shqipërisë për një afat më shumë se 90 ditë në 180 ditë dhe që plotësojnë kushtet e përcaktuara në këtë ligj:

a) leje qëndrimi e tipit “A”, e cila i jep të drejtën mbajtësit vetëm të qëndrojë në Republikën e Shqipërisë brenda afatit kohor për të cilën ajo lëshohet;

b) leje qëndrimi ose leje unike e tipit “B”, e ripërtëritshme, e cila lëshohet me afat të përcaktuar dhe i jep të drejtën mbajtësit të hyjë, të qëndrojë dhe të dalë në/nga Republika e Shqipërisë brenda afateve të përcaktuara në të;

c) leje qëndrimi ose leje unike e tipit “C”, e cila lëshohet me afat të përhershëm dhe i jep të drejtën mbajtësit të hyjë, të qëndrojë dhe të dalë në/nga Republika e Shqipërisë; ç) leje qëndrimi unike “Kartë Blu AL”, e ripërtëritshme, e cila lëshohet me afat të përcaktuar vetëm për punonjës me kualifikim të lartë dhe i jep të drejtën mbajtësit të hyjë, të qëndrojë dhe të dalë në/nga Republika e Shqipërisë brenda afateve të përcaktuara në të;

d) leje qëndrimi “Kartë Blu AL-C”, e cila lëshohet me afat të përhershëm vetëm për punonjës me kualifikim të lartë dhe i jep të drejtën mbajtësit të hyjë, të qëndrojë dhe të dalë në/nga Republika e Shqipërisë.”

Në kuptim të nenit 32, të këtij ligji, i huaji, i cili ka hyrë dhe qëndron në Republikën e Shqipërisë me një vizë qëndrimi afatgjatë të tipit “D”, ose ai që hyn pa vizë, brenda afateve të përcaktuara në këtë ligj ose në marrëveshje ndërkombëtare, i bën një kërkesë online autoritetit vendor përgjegjës për kufirin dhe migracionin për t’u pajisur me leje qëndrimi. Për personat që hyjnë me vizë, motivi i lejes së qëndrimit duhet të përputhet me motivin e vizës, me të cilën i huaji ka hyrë në Republikën e Shqipërisë.

Në pikat 2-3 të këtij neni përcaktohet se autoriteti shtetëror qendror përgjegjës për trajtimin e të huajve, pas konsultimit me Shërbimin Informativ të Shtetit dhe shërbimet e rendit dhe sigurisë, miraton leje qëndrimi, ndërsa autoriteti shtetëror përgjegjës në nivel rajonal/vendor për trajtimin e të huajve i lëshon të huajt lejen e qëndrimit.

Bashkëpunimi për procedurat e lëshimit ndërmjet ministrisë përgjegjëse për rendin dhe sigurinë publike, Shërbimit Informativ të Shtetit dhe ministrisë përgjegjëse për financat e ekonominë përcaktohet me udhëzim të përbashkët të këtyre institucioneve.

Sipas pikës 4, të këtij neni leja e qëndrimit, nëse nuk është përcaktuar ndryshe në këtë ligj apo me marrëveshje ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, jepet me një afat:

a) 3 muaj, 6 muaj ose 1 vit, ku leja 1-vjeçare mund të ripërtërihet jo më shumë se 5 herë radhazi;

b) 2 vjet, e cila mund të ripërtërihet jo më shumë se një herë,

c) 5 vjet, sipas përcaktimeve të këtij ligji;

ç) e përhershme, në rast se i huaji ka pasur qëndrim të ligjshëm për 5 vjet radhazi në Shqipëri dhe ka lidhje ose veprimtari të qëndrueshme në vend.

Në nenin 34, pika 1 të ligjit nr.79/2021 “Për të huajt” parashikohen shprehimisht rastet e refuzimit të kërkesës së lejes së qëndrimit, të cilat citohen si më poshtë:

“1. Lëshimi ose ripërtëritja e lejes së qëndrimit mund të refuzohet ose mund të anulohet nëse:

a) i huaji nuk ka arritur ta dorëzojë kërkesën apo të plotësojë dokumentacionin e nevojshëm brenda afatit të përcaktuar dhe nuk paraqet arsye të besueshme që të justifikojë moskryerjen e këtij veprimi;

b) i huaji nuk është në gjendje të vërtetojë se plotëson ose nuk plotëson më kushtet e kërkuara për qëndrim, sipas kriterëve të kërkuara;

c) i huaji përbën kërcënim për rendin dhe sigurinë publike, sigurinë kombëtare dhe është bërë subjekt i largimit nga territori i Republikës së Shqipërisë;.....”

Institucionet përkatëse kanë përdorur si bazë ligjore në aktet e tyre dispozitat e Ligjit nr. 108/2013 “Për të huajt”, i ndryshuar, ndërkohë që prej fundit të muajit korrik 2021, ka hyrë në fuqi të ligji nr.79/2021 “Për të huajt”, i cili ka shfuqizuar ligjin paraardhës. Në këtë kontekst, KMD ka përdorur si referencë dispozitat e ligjit te ri.

Për sa më sipër, ankuesi M.O.B., është shtetas i huaj, i lindur në Corlu, Turqi dhe për disa vite ka qenë banues në qytetin e Sarandës, pasi autoritetet shqiptare i kanë lëshuar leje qendrimi. Fillimisht, z. M.B. është trajtuar me Leje Pune për të Huaj, tipi A/P, nr. 171 prot., datë 25.06.2018, për periudhën kohore 24.06.2018-23.06.2019. Në vijim, Z. M.B. është pajisur me Leje Qendrimi për të Huaj, Tipi B, për një periudhë 1 vjeçare, për motiv punësimi (si operator turistik-menaxher) me afat vlefshmërie nga data 11.06.2019-11.06.2020. Leja e qendrimit i është miratuar nga institucionet përgjegjëse sipas procedurave të parashikuara në aktet ligjore dhe nënligjore. Në vijim, ankuesi ka aplikuar për ripërtëritjen e lejes së qendrimit për arsye vetëpunësimi me afat 1 vjeçar, duke u pajisur me leje qendrimi me afat vlefshmërie 1 vjeçare nga data 12.06.2020-12.06.2021, pas vlerësimit të kërkesës për ripërtëritje të lejes së qendrimit sipas procedurave ligjore.

Në zbatim të Urdhërit nr. 154, datë 25.11.2019, të Kryeministrit, “Për marrjen e masave dhe rregullimin e dispozitave ligjore për aplikimin e shërbimeve on line nga data 01.01.2020” në cilësinë e shtetasit të huaj, në datën 06.05.2021, ankuesi ka aplikuar në portalin E-Albania me nr. çështje DPPSH-202133711272-MB, për ripërtëritjen e lejes së qendrimit me afat 2 vjeçar.

Nëpërmjet Urdhërit nr. 919/2, datë 07.07.2021, të Drejtorisë Rajonale të Kufiit dhe Migracionit Vlorë, ankuesi është urdhëruar për largim nga territori i Republikës së Shqipërisë, me motivacionin “*nuk plotëson kushtet e qendrimit në Shqipëri*”. Sipas pikës 4, të këtij urdhëri, shtetasit turk i ndalohet hyrja në Republikën e Shqipërisë deri në datën 07.07.2026. Në vijim, nëpërmjet shkresës nr. 919/3 prot., datë 07.07.2021, me lëndë “*Njoftim për refuzimin e lejes së qendrimit dhe Urdhërit të Largimit*”, Drejtoria Vendore për Kufirin dhe Migracionin Vlorë i ka bërë të ditur ankuesit si vijon: “*.....Ju njoftojmë se bazuar në nenin 35, pika 1/c të ligjit nr. 108/2013 “Për të huajt” ju është refuzuar kërkesa për ripërtëritjen e lejes tuaj të qendrimit depozituar në Komisaratin e Policisë Kufitare dhe Migracionin Sarandë, si dhe është lëshuar Urdhër largimi për largimin nga territori i Republikës së Shqipërisë sipas procedurës ligjore. Nga ana juaj kërkohet të zbatohen detyrimet e përcaktuara në Refuzimin e Lejes së Qendrimit me nr. Prot. 919/1, datë 07.07.2021 dhe Urdhërit të largimit me Nr. 919, datë 07.07.2021 sipas afateve ligjore. Ju keni të drejtën e ushtrimit të ankimit administrative për Refuzimin e Lejes së Qendrimit sipas nenit 36, pika 1 dhe 2, të ligjit nr. 108/2013 “Për të huajt” i ndryshuar. Ju njoftojmë gjithashtu se*

autoritetit epëror i drejtpërdrejtë i Drejtorisë vendore për Kufirin dhe Migracionin Vlorë që ka nxjerrë refuzimin e lejes suaj të qëndrimit dhe Urdhërin e Largimit është Departamenti për Kufirin dhe Migracionin, në varësi të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, në Tiranë, me adresë në Bulevardin “Bajram Curri”, Tiranë, të cilit mund t’i drejtoni kërkesën për ankim dhe shqyrtim të mëtejshëm administrativ.”

Ankuesi ka ushtruar të drejtën e tij të ankimit kundër akteve të sipërcituara pranë Departamentit për Kufirin dhe Migracionin, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit nëpërmjet ankimit të datës 24.05.2021. Ky Departament i ka kthyer përgjigje ankuesit nëpërmjet shkresës nr. M-36/1 prot., datë 23.07.2021, ku e bën me dije se lëshimi i urdhërit të largimit nga territori i RSH-së është bërë në zbatim të procedurave ligjore të normuara në ligjin nr. 108/2013 “Për të huajt”, i ndryshuar, neni 106, pika 1 (a), pasi i huaji nuk plotëson më kushtet e qëndrimit në Republikën e Shqipërisë për shkak të refuzimit të lejes së qëndrimit më datë 07.07.2021, bazuar në përcaktimit e nenit 35 pika 1(c), të ligjit të sipërcituar. Njëkohësisht, Departamenti për Kufirin dhe Migracionin e bën me dije ankuesin se ai ka të drejtën e ankimit administrativ pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Administrative.

Ankuesi ka sqaruar në ankesën e tij drejtuar KMD-së se gjatë qëndrimit të tij në Shqipëri ka ushtruar biznesin e tij të ligjshëm si person fizik, i cili konsiston në një agjensi turistike me vendndodhje në Ksamil, Vlorë, si dhe është pronar i anijes Nordic Berry, e cila është e regjistruar në Portin e Durrësit dhe është lejuar të lundrojë me Flamurin e Republikës së Shqipërisë, deri në datën 19.04.2022. Ankuesi ka theksuar faktin se biznesi i tij është i regjistruar pranë organeve tatimore dhe se ai ka qenë tatim/taksapagues i rregullt pranë të gjithë institucioneve përgjegjëse.

Gjatë korrespondencës zyrtare të patur me subjektet kundër së cilave drejtohet ankesa, si dhe mbështetur në dokumentacionin e paraqitur nga Departamenti për Kufirin dhe Migracionin, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, Komisioneri ka konstatuar se mungon prova kryesore që ka shërbyer si shkak për refuzimin e lejes së qëndrimit nga Drejtoria për Kufirin dhe Migracionin Vlorë. Subjektet kanë sqaruar se shkak i largimit të ankuesit nga Shqipëria ka lidhje me parashikimin për mosplotësim të kriterëve të qëndrimit sipas pikës 1 gërma (c) të nenit 35 të ligjit nr. 108/2013 “Për të huajt”, i ndryshuar (aktualisht i shfuqizuar), ku parashikohej: “1. Lëshimi ose ripërtëritja e lejes së qëndrimit mund të refuzohet apo mund të anulohet nëse:c) i huaji është bërë subjekt i largimit nga territori i Republikës së Shqipërisë;”⁷

⁷ Aktualisht, në ligjin nr. 79/2021 “Për të huajt” parashikimi analog përcaktohet në nenin 35, pika 1, gërma c), ku thuhet se: “Lëshimi ose ripërtëritja e lejes së qëndrimit mund të refuzohet ose mund të anulohet nëse:i huaji përbën kërcënim për rendin dhe sigurinë publike, sigurinë kombëtare dhe është bërë subjekt i largimit nga territori i Republikës së Shqipërisë”

Për sa më sipër, Departamenti për Kufirin dhe Migracionin, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit e ka sqaruar KMD-në, se procedurat për lëshimin apo rinovimin e lejes së qëndrimit për shtetasit e huaj, ndër të tjera përfshijnë edhe vlerësimin në rrugë elektronike dhe shkresore nga autoritete të tjera ligjzbatuese dhe ky komunikim është i klasifikuar.

Mbështetur në dispozitat e ligjit nr. 8457, datë 11.02.1999 “*Për informacionin e klasifikuar sekret shtetëror*”, strukturat e migracionit në Departamentin për Kufirin dhe Migracionin ndjekin me rigorozitet procedurën e mirëpërcaktuar për trajtimin e rasteve të refuzimit të lejes së qëndrimit për shkak të cënimit të sigurisë publike dhe kombëtare nga i huaji, duke i njoftuar të huajit vetëm bazën ligjore, të cilës i referohet ky refuzim, ndërkohë që nuk lejohet t’i komunikohet informacioni origjinal i klasifikuar apo struktura e burimit të këtij informacioni.

Referuar korrespondencës me Departamentin për Kufirin dhe Migracionin rezulton se strukturat qendrore dhe vendore të Departamentit për Kufirin dhe Migracionin, që janë përkatësisht Drejtoria për Kufirin dhe Migracionin Vlorë dhe Komisariati i Kufirit dhe Migracionit Sarandë, të cilat kanë trajtuar aplikimin për rinovimin e lejes së qëndrimit të këtij shtetasi nuk kanë asnjë dijeni mbi motivin e saktë të refuzimit të lejes së qëndrimit të këtij shtetasi. Ky informacion konsiderohet i klasifikuar dhe mund t’i njoftohet nga struktura burim, vetëm strukturave superiore në Policinë e Shtetit apo Ministrinë e Brendshme (Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit dhe Ministrin të Brendshëm) me kërkesë të tyre.

Ky Departament ka theksuar faktin se në asnjë rast këto informacione nuk mund të përdoren si provë në gjykim apo referencë publike për argumentimin e një mase të karakterit zyrtar administrativ, siç është refuzimi i lejes së qëndrimit në Republikën e Shqipërisë.

Për sa më sipër, Komisioneri gjykon se duke mos patur informacion lidhur me arsyet e refuzimit të lejes së qëndrimit të këtij shtetasi, si dhe në kushtet kur, ky informacion është i klasifikuar dhe nuk mund të jetë i disponueshëm për KMD-në gjatë hetimit administrativ të ankesës së z. M.B., është e pamundur për dalë në përfundimin se ankuesi është ekspozuar ndaj një qëndrimi të padrejtë, disfavorizues e të pabarabartë nga subjektet përkatëse. Në mungesë të dokumentacionit për të vërtetuar situatën diskriminuese të pretenduar nga subjekti ankues dhe në mbështetje të nenit 95, të Ligjit nr. 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”, ku parashikohet: *Pamundësia në objekt apo qëllim: “Organi publik deklaron të përfunduar procedurën administrative pa një vendim përfundimtar për çështjen, kur objekti për të cilin kishte nisur procedura apo qëllimi i tij është bërë i pamundur”,* Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi vendosi pushimin e shqyrtimit të çështjes.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 95, të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, nenit 32/1, gërma a), si dhe nenit 33, pikat 10 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Ndërprerjen e procedurave hetimore dhe pushimin e shqyrtimit të çështjes mbi ankesën nr. 152, datë 05.08.2021, e z. M.O.B., për shkak të pamundësisë për të siguruar informacionin e nevojshëm për marrjen e një vendimi përfundimtar.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijëni.

KOMISIONER

Robert GAJDA

Fusha – Të mira dhe shërbime
Shkak – origjina dhe statusi i huaj
Lloji i vendimit – Ndërprerje e procedurave hetimore dhe pushim i çështjes